



## AKTI I THEMELIMIT

### KONTRATE

#### PER

### THEMELIMIN E SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR ME EMRIN "HYSENBELLIU"

Kjo kontrate per themelimin e nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar (sh.p.k.), e cila me poshte do te quhet "Kontrata", perfaqesohet dhe themelohet nga:

**Bardhyl HYSENBELLIU**

**Nr. pashaporte: 04 33 834**

**Datelindja 27/05/1967**

**Vendlindja: Skrapar, Shqiperi**

**Vendbanimi: Rr. "1 Maji" Pall. 23 Ap. 44**

**Tirane Shqiperi**

Me lidhjen e kesaj kontrate Z. Bardhyl Hysenbelliu ka qellim te themeloje nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar ( sh.p.k.), e cila me poshte do te quhet "Shoqeria".

Perfaqesuesi ne kete kontrate bie dakort per sa me poshte vijon:

#### NENI 1

Me anen e kesaj kontrate themelohet shoqeria me pergjegjesi te kufizuar (sh.p.k.) e cila emerohet "HYSENBELLIU" SH.P.K.




## NENI 2

Ne përputhje me legjislacionin shqiptar, shoqeria eshte person juridik dhe veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave te kesaj kontrate, statutit te saj, sipas ligjit "Per shoqerite tregtare", si dhe te akteve te tjera ligjore. Statuti i shoqerise i bashkelidhet kesaj kontrate dhe eshte pjese e pandare e perberese e saj.

## NENI 3

Shoqeria ka per objekt te veprimtarise:

- Eksport - Importin e mallrave te ndryshem industriale, bujqesore, ushqimore, mjeksore e tjere, si edhe shitjen e tyre me shumice dhe pakice.
- Tregetin e drithrave, perimeve, frutave si dhe te gjitha llojet e tjera te produkteve ushqimore dhe perpunimin e tyre.
- Tregtimin e pijeve alkolike, freskuese, te ujit, duhanit e cigareve si dhe punimin e perpunimin e tyre.
- Tregtimin e perpunimin e lekureve, te tekstileve e konfeksioneve. Tregtimin e artikujve mekanike, te artikujve e pajisjeve elektrike, telefonike, elektronike, te makinave e te pjeseve te kembimit te tyre, te makinave e te pajisjeve bujqesore, te materialeve te ndertimit e te pajisjeve hidrosanitare, te letres te kinkalerrise per zyra, si dhe bilet mjeksore, medikamenteve dhe te atyre detare, (peshkimi).
- Tregtimin e lendeve te para, te materialeve drusore dhe perpunimin e tyre. Tregtimin e naftes dhe te derivateve te saj. Tregtimin e artikujve te ndryshem kimike, si dhe bojrave te llojeve te ndryshme per lysterje.
- Ushtrimin e veprimtarise ne fushen e turizmit, te hotelerise e restoranteve, ne fushen e ndertimit, ne fushen e transporteve te marketingut, ne fushen doganore, ne fushen mjeksore, ndertim spitalesh.
- Ushtrimin e veprimtarise ne fushen e komunikacionit, mediave, botimeve, prodhimeve audio vizuale, shtypshkrimeve.



**Eksport - Importin e lendes se pare te shtypshkrimit, letres e tjere.**

**- Ushtrimin e veprimtarise ne fushen e peshkimit si dhe eksport e import brenda kesaj hapesire.**

#### **NENI 4**

**Selia e shoqerise eshte ne Rr: "Asim Vokshi" Pall. 141, Sh 2 Apa. 14 Tirane, Albania.**

#### **NENI 5**

**Emri, selia dhe objekti i veprimtarise se shoqerise mund te ndryshoje vetem me vendim te presidentit te kesaj shoqerie.**

#### **NENI 6**

**Shoqeria do te filloje veprimtarine e saj, nga data e regjistrimit ne regjistrin kombetar ne gjykatën e rrethit Tirane, ne organin e tatimeve dhe do te vazhdoje deri ne fund te vitit 2050.**


#### **NENI 7**

**Shoqeria ka vulen perkatese me stemen e saj, e cila miratohet nga palet ortake ne kete kontrate.**

#### **NENI 8**

**Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100 000 leke.**

**Kapitali ndahet ne 100 kuota me vlere 1000 (njemije) leke secila, te emertuara nje deri ne njeqind. Ne kapitalin themeltar do te kontribuoje Z. Bardhyl Hysenbelliu.**



#### **NENI 9**

Kapitali themeltar do te derdhet ne para nga Z. Bardhyl Hysenbelliu sipas rregullave te caktuara ne statutin e shoqerise.

Veprimet e depozitimit ne banke ose ne noteri te kapitalit themeltar do te behen nga Z. Bardhyl Hysenbelliu

#### **NENI 10**

Shoqeria lejohet te hyje ne marrredhenie bashkepunimi me persona te tjere juridike e fizike. Ajo ka te drejte te krijojte edhe shoqeri te perbashketa ose te marre pjese ne shoqeri te tilla.

#### **NENI 11**

Perfaqesuesi ne kete shoqeri nuk pergjigjet per detyrimet e shoqerise qe rrjedhin nga objekti i veprimtarise se saj, tej kapitalit themeltar ne te cilen ai ka marre pjese. Po keshtu edhe shoqeria nuk pergjigjet per detyrimet personale te tij.

#### **NENI 12**

Shoqeria do te drejtohet nga keto organe:

1. Administratori i Pergjithshemi
2. Asamblea e Pergjithshme
3. Ekspertet kontabel te autorizuar

#### **NENI 13**

Vendimet e shoqerise merren nga Z. Bardhyl Hysenbelliu. Rregullat per veprimtarine e shoqerise dhe Asamblene e Pergjithshme caktohen ne statutin e shoqerise qe i bashkelidhet kesaj kontrate.



**NENI 14**

~~Z. Bardhyl Hysenbelliu~~ emerohet Administrator i Pergjithshem shoqerise.

**NENI 15**

Administratori i Pergjithshem mund te caktoje eksperte kontabel te autorizuar ne mbledhjen e pare te Asamblese se Pergjithshme, pas regjistrimit te shoqerise ose edhe me vone. Ne keto mbledhje do te vendoset per numrin e eksperteve te cilet do te jene ekonomiste apo juriste.

**NENI 16**

Ne vendin qe do te percaktoje Administratori i Pergjithshem do te mbahen te plota dhe te sakta libra llogarie ne te cilat do te pasqyrohet gjendja e biznesit si edhe financat e shoqerise. Do te mbahet gjithashtu i gjithe dokumentacioni i nevojshem i shoqerise. Ne cdo moment presidenti ka te drejte te ushtroje kontrroll ne keto libra e dokumenta.

**NENI 17**


Per kryerjen e veprimtarise se saj shoqeria do te cele llogari bankare.

**NENI 18**

Shoqeria priset me mbarimin e afatit te parashikuar ne kete kontrate, ne rast se Administratori i Pergjithshem nuk e perserit ate, ose per shkaqe te ligjshme.

**NENI 19**

Kur shoqeria priset nis procedura e likuidimit te saj. Likuduesit caktohen nga Administratori i Pergjithshem dhe veprojne ne perputhje me kerkesat e ligjit me nenet 264, 275 te ligjit "Per shoqerite tregtare".



**NENI 20**

Kur shoqeria likujdohet, likujduesi i paraqet Asamblese se Pergjithshme bilancin e likujdimit. Shoqeria i jep fund veprimtarise se saj ne castin e miratimit te bilancit te likujdimit. Mjetet financiare dhe cdo pasuri tjeter qe shoqeria do te kete, kur ajo te likujdohet i mbeten presidentit te shoqerise.

**Administrator i Pergjithshem i Shoqerise**

**Z. Bardhyl Hysenbelliu**

*Bardhyl Hysenbelliu*

**NOTERE:**



Quellenverzeichnis

116

1. <sup>1</sup> Hagenbellin, Jura - 1996 -  
Jr.

b. <sup>1</sup> Jura

c. <sup>1</sup> Jura - Jura, Jura, Jura  
f. <sup>1</sup> Jura, Jura, Jura

Jura

3. <sup>1</sup> 100. 200 Jura

4. <sup>1</sup> Jura, Jura, Jura

Jura, Jura, Jura  
Jura, Jura

Jura, Jura, Jura 10.05.1995  
Jura 11.05.1998

Jura  
Jura, Jura - Jura

Wesley

9. 1842

b.

✓ published

c.

✓ by some persons.

(M. W. C.)

✓ note from [unclear]  
for [unclear]



# STATUT I SHOQERISE SE KUFIZUAR

"HYSENBELLIU"

Perfaqesuesi i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar:

Z. Bardhyl HYSENBELLIU Nr. Pashaporte 04 33 834

Datelindja 27/05/1967

Vendlindja: Skrapar Shqiperi

Vendbanimi: Rr. "1 Maji" Pall. 23 Ap. 44

Tirane Shqiperi

Vec kontrates per themelimin e shoqerise, sot ne daten 10/06/1998 nenshkroi ne Tirane edhe statutin e saj qe eshte pjese perberese e kontrates se themelimit me permbajtje si vijon:

KAPITULLI I

EMRI SELIA DHE KOHEZGJATJA E SHOQERISE

## NENI I


Shoqeria emerohet "HYSENBELLIU" dhe eshte shoqeri me pergjegjesi te kufizuar Sh. P. K

## NENI 2

Shoqeria e ka seline e saj ne Tirane me kete adrese Rr. Asim Vokshi Pall 141 Sh. 2 Ap. 14 Tirane Albania.

Selia e shoqerise mund te ndryshohet me vendim te Asamblese se Pergjithshme dhe te Administratorit te Pergjithshem te saj.

Shoqeria ka te drejte te hape filiale te saj ose agjensi ne qytetet e tjera te Republikes se Shqiperise ne perputhje me rregullat e shtetit perkates.



### NENI 3

Shoqeria do te ushtroje veprimtarine e saj deri ne vitin 2030. Kjo periudhe kohe mund te zgjatet me vendim te Administratorit te Pergjithshem te saj. Shoqeria mund te mbylle veprimtarine e saj ne cdo kohe edhe para afatit, por vetem kur te kete vendosur me vullnet te plote nga Administratori i Pergjithshem.

### KAPITULLI II

### OBJEKTI I VEPRIMTARISE

### NENI 4

Shoqeria ka per objekt te veprimtarise:

- Eksport - Importin e mallrave te ndryshem industriale, bujqesore, ushqimore, mjeksore e tj si dhe shitjen e tyre me shumice dhe pakice.

- Tregtimin e drithrave, perimeve, frutave, si dhe te gjitha llojet e tjera te produkteve ushqimore dhe perpunimin e tyre.

- Tregtimin e pijeve alkolike, freskuese, te ujit, duhanit e cigareve si dhe punimin e perpunimin e tyre.

- Tregtimin e perpunimin e lekureve, te tekstileve e konfeksioneve. Tregtimin e artikujve mekanike, te artikujve e pajisjeve elektrike, telefonike, elektonike, te makinave e te pjeseve te kembimit te tyre, te makinave e te pajisjeve bujqesore, te materialeve te ndertimit e te pajisjeve hidrosanitare, te letres te kinkalerise per zyra, si dhe bimet mjeksore, medikamente dhe te atyre detare, (peshkimi).

- Tregtimin e lendeve te para, te materialeve drusore dhe perpunimin e tyre. Tregtimin e naftes dhe te derivateve te saj. Tregtimin e artikujve te ndryshem kimike, si dhe bojrave te llojeve te ndryshme per lyerje.

- Ushtrimin e veprimtarise ne fushen e turizmit, te hotelkerise e restoranteve, ne fushen e ndertimit,

ne fushen e te gjitha llojeve te transportit te marketingut, ne







**KAPITULLI IV**

**ASAMBLEA E PERGJITHSHME**

**NENI 8**

Asamblea e Pergjithshme thirret nga Administratori i Pergjithshem,

ose nga eksperti kontabel i autorizuar nese ka nje te tille. Njoftimi per mbledhjen e asamblese behet 15 dite para dates se caktuar per zhvillimin e saj.

**NENI 9**

Asamblea eshte e zakonshme dhe e jashtezakonshme. Asamblea e zakonshme duhet te thirret te pakten nje here ne vit brenda kater muajve nga mbyllja e ushtrimit te veprimtarise financiare te shoqerise. Per arsye te vecanta asamblea e zakonshme mund te thirret brenda gjashte muajve nga mbyllja e ushtrimit te veprimtarise financiare vjetore e shoqerise.


Asamblea e jashtezakonshme thirret per te ushtruar kompetencat e saj kur Administratori i Pergjithshem dhe Administratoret e quajne te nevojshme si dhe ne rastet e parashikuara ne ligj. Njoftimi per thirrjen e mbledhjes duhet te behet ne perputhje me rregullat e caktuara ne kete statut dhe me kerkesat e ligjit.

**NENI 10**

Ne mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme kane te drejte te marrin pjese Administratori i Pergjithshem, administratoret te cilet rezultojne te regjistruar ne librin e shoqerise.

**NENI 11**

Asambleja e Pergjithshme kryesohet nga Administratori i Pergjithshem. Ajo emeron edhe nje sekretar.



## NENI 12

Asambleja e zakonshme ose e jashtezakonshme, mund te thirret nga Administratori i Pergjithshem.

## NENI 13

Vendimet e Asamblese se Pergjithshme te marra konform me ligjin, statuti dhe kontrata e themelimit, jane te detyrueshem per te gjithë punonjesit e shoqerise megjithese ata mund te mos kene qene te pranishem.

## NENI 14

Administratori i Pergjithshem ka ne kopetence te vendose per te gjitha ceshtjet qe ajo i quan te rëndesishme dhe te nevojshme per mbarevajtjen e veprimtarise se Shoqerise. Ai percakton masen e pages e te shperblimit mujor te punonjesve te administrates dhe te punonjesve te tjere te shoqerise.

## KAPITULLI V

## ADMINISTRATORI

## NENI 15

Shoqeria do te te administrohet nga administratore te cilet mund te zgjidhen nga Administratori i Pergjithshem i shoqerise.

Administratoret emerohen per here te pare qe me aktin e themelimit te Shoqerise dhe me pas me perfundimin e afatit te percaktuar, ata mund te rizgjidhen nga Administratori i Pergjithshem..

Administratori i Pergjithshem vendos per numrin e administratoreve qe do te drejtojne shoqerine. Administratoret edhe pse jane te zgjedhur, mund te heqin dore nga detyra duke i njoftuar me shkrim Administratorin e Pergjithshem dy muaj para dates se largimit te tyre.



## NENI 16

Administratori i Pergjithshem ka te drejte te kryeje te gjitha veprimet qe nuk jane te ndaluara dhe qe konsiderohen te nevojshme per zhvillimin e Shoqerise. Ai duke qene perfaqesues i shoqerise ka te drejte te hyje ne mardhenie kontraktore me persona juridike ose fizike, mund te krijojne lidhje me shoqeri tregtare shqiptare ose te huaja, te kryeje veprime depozitimi, kreditimi, pagese ose arketimi prane institucioneve bankare e financiare, si edhe te kryeje cdo lloj veprimtarie ne dobi te shoqerise e ne perputhje me objektin e saj te veprimtarise te percaktuar ne Statut e ne Aktin e Themelimit.

## NENI 17

Administratori i Pergjithshem perfaqeson shoqerine ne te tretet. Ai ka te drejte te perfaqesoje shoqerine dhe ne organet gjyqesore si edhe ne te gjitha llojet e tjera te organeve shteterore per mbrojtjen e interesave te shoqerise.

## NENI 18

Administratori i Pergjithshem per te rritur pergjegjesine e tij ne kryerjen e detyres i jepet kompetenca qe te pranoje e te pushoje nga puna punetoret e nenpunesit e shoqerise ne perputhje me rregullat ligjore ne fuqi. Ai ka te drejte te propozoje e te paraqese per miratim ne Asamblene e Pergjithshme emerimin e drejtoreve dhe caktimin e kompetencave te tyre. Ai ka te drejte gjithashtu te hape ne emer te tij llogari bankare dhe te beje veprimet ne banke, te konvertoje, te transferoje, te marre kredi bankare, te hipotekoje prona te shoqerise, si edhe prona te tjera qe ai i sheh te arsyeshme per shoqerine. Ai ka ekskluzivitet te plote per cdo veprim te shoqerise.



**KAPITULLI VI**

**EKSPERTET KONTABEL TE AUTORIZUAR**

**NENI 19**

Asambleja e Pergjithshme mund te emeruje nje ose disa eksperte kontabel te autorizuar ne zbatim te kerkesave te percaktuara ne nenin 59 te ligjit "Per shoqerite tregtare", per kontrollimin e garantimin e rregullise se llogarive vjetore te shoqerise.

**KAPITULLI VII**

**BILANCI PER TE ARDHURAT**

**NENI 20**

Ushtrimi i vitit financiar te shoqerise fillon me 1 Janar dhe mbyllet me 31 Dhjetor te cdo viti.

**NENI 21**

**Raporti i Administratorit te Pergjithshem se bashku me bilancin**

depozitohen ne seline e shoqerise 15 dite perpara dates se caktuar per mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme, ne menyre qe te njihet permbajtja e saj.

**NENI 22**

Fitimi qe mbetet ne fund te vitit financiar pas zbritjes se fondit te rezervave ose te fondeve te tjera te detyrimeve fiskale e te shpenzimeve i kalon shoqerise



KAPITULLI VIII

KONTROLLI I ADMINISTRATORIT TE PERGJITHSHEM

**NENI 23**

Administratori i Pergjithshem ka te drejte te kerkoje informacion per ecurine e punes se shoqerise, prej stafit punonjes dhe te konsultohet me librin dhe dokumentat e shoqerise.

Ai mund te ndihmohet nga nje ekspert i zgjedhur prej tij, i cili i nenshtrohet detyrimit per ruajtjen e sekretit profesional.

KAPITULLI IX

PRISHJA E SHOQERISE

**NENI 24**

Asambleja e Pergjithshme dhe Administratori i Pergjithshem kur Shoqeria prishet emeron nje ose disa likuidatore per kryerjen e formaliteteve te likuidimit duke percaktuar edhe kompetencat dhe fuqite e tyre.

KAPITULLI X

ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE

**NENI 25**

Te gjitha mosmarreveshjet eventuale midis shoqerise dhe likuiditoreve do te zgjidhen nga gjykata e rrethit Tirane.

Megjithate para se keto mosmarreveshje t'i kalojne per shqyrtim gjykates, me deshiren e paleve ato mund te zgjidhen nga nje arbiter i cili do te caktohet prej tyre me marreveshje te perbashket.

Secila pale qe nuk do te jete dakort me vendimin e arbitrit ka te drejte qe perfundimisht t'i drejtohet gjykates se rrethit te Tiranes, per zgjidhjen e ceshtjes.





KAPITULLI XI

DISPOZITA TE PERGJITHSHE

**NENI 26**

Per sa nuk eshte parashikuar ose shprehur ne dispozitat e ketij statuti referimi do te behet ne legjislacionin ne fuqi ne Republiken e Shqiperise.


**NENI 27**

Kjo kontrate hartohet ne shqip. Ajo behet ne pese kopje dhe firmoset rregullisht nga Administratori i Pergjithshem sot ne daten 10.06.98 ne Tirane.

**ADMINISTRATORI I PERGJITHSHEM**

Bardhyl HYSENBELLIU

Bardhyl Hysenbelliu



**NOTERE:**